



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 MAJ 2009

T R A N S K R I P T

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. MAJA 2009. GODINE

MAJ - MAJ
2009

E premte, 15 maj 2009, ora 10:00.

Drejtoi seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare!
Konstatoj që në sallë janë 99 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Rendin e ditës dhe materialin e keni marrë.
Pika e parë e rendit të ditës për seancën e sotme plenare është:

- Shqyrtimi i propozimit për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërimin në Gjykatën Kushtetuese, pas përfundimit të shqyrtimit të listës së kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, ka hartuar Raportin me rekomandime dhe Kuvendit i rekomandon listën e kandidatëve për shqyrtim në seancë plenare.

Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, në takimin e mbajtur më 13 maj 2009, është pajtuar që t'i propozojë Kuvendit votimin e kandidatëve përmes sistemit elektronik.

Nga gjashtë gjyqtarët, katër do të zgjedhën me 2/3 e votave të deputetëve prezent që votojnë. Dy do të zgjedhën me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit pas pëlqimit të shumicës të deputetëve të Kuvendit, që i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

Kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare, që të procedojnë listën e kandidatëve të mundshëm për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Fjalën e ka deputeti, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,
I nderuar zoti Kryeministër dhe zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,
Kolegë të respektuar dhe të nderuar deputetë,

Për ta përshpejtuar procedurën dhe mbase për ta bërë më të lehtë këtë procedurë të zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ne si grup parlamentar kemi menduar që

të dalim me një listë më të ngushtë të kandidatëve për t'u përzgjedhur sot nga vota e deputetëve dhe kjo listë jona, duke mos i futur dy minoritarët për faktin që ata do të zgjidhen në formën e veçantë një herë dhe më pastaj të përbashkët, anëtarë të kësaj liste janë këta pretendues për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese:

1. Enver Hasani,
2. Gjyljeta Mushkolaj,
3. Kadri Kryeziu dhe
4. Iliriana Islami

KRYETARI: Ju faleminderit! Ju njoftoj se në sallë kemi 100 deputetë. Radha është e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet listën e përbashkët të partnerëve të koalicionit, natyrisht pas një pune që ka bërë paneli. Ky panel është udhëhequr nga vetë Kryetari i Kuvendit edhe shefat e grupeve parlamentare kryesisht kanë qenë pjesë e këtij procesi. Pas konsultimeve të vazhdueshme, ne sot kemi ardhur në përfundim dhe si grup parlamentar do ta votojmë listën e përbashkët të anëtarëve për Gjykatën Kushtetuese dhe, po ashtu, në parim mbështesim edhe kandidatët nga grupet minoritare që do të propozohen këtu.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të AKR-së. Ju njoftoj se të gjitha grupet parlamentare kanë të drejtë të dalin me listat e tyre të kandidatëve. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Rita Hajzeraj e ka kërkuar fjalën.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zoti Kryetar, është mirë që opinioni i gjerë dhe populli shqiptar ta dinë se këtu po bëhet një padrejtësi shumë e madhe. Duke e pasur parasysh që ky Parlament ka formuar një komision, një panel intervistues që t'i intervistojë të gjithë të kandiduarit për Gjykatën Kushtetuese. Pra, vendimi i këtij Parlamenti sot po shkelet, duke e marrë vendim Kryesia e Parlamentit të Kosovës, pa konsultimin dhe pa marrjen e votave të të gjithë deputetëve të cilët e kanë votuar Komisionin.

KRYETARI: Ju njoftoj deputete, Grupi i juaj Parlamentar ka pasur një anëtar të Kryesisë dhe një shef të Grupit Parlamentar. Pra, anëtari i Kryesisë dhe shefi i Grupit Parlamentar janë pajtuar që ta kenë listën e vet. Të lutem, në emër të...

RITA HAJZERAJ: Zoti Kryetar, unë jam duke folur dhe ju kisha lutur që kur ta përfundoj unë fjalën, në bazë të Rregullores, ta merrni ju dhe të tregoni se si kam të drejtë të flas.

(Reagime në sallë)

Ne, si Grup Parlamentar, me qenë se qenkeni marrë vesh, e kemi bërë edhe një listë, por kjo fare nuk është në seriozitetin e punës së Parlamentit dhe çdo ditë po shihet se puna e Parlamentit po shkelet.

Zoti Kryetar,

Për hir të përgjegjësisë, ne si grup parlamentar kemi bërë një listë, duke mos i anashkaluar kandidatët të cilët kanë pasur vota më së shumti gjatë Panelit intervistues dhe ku Kryetar keni qenë ju dhe e keni kryesuar atë panel, ku tani më nuk e keni besimin e atij paneli. Personat të cilët ne i kemi zgjedhur janë :

1. Riza Smaka,
2. Dr. Enver Hasani,
4. Gjyljeta Mushkolaj dhe
5. Fejzullah Berisha

KRYETARI: Ju faleminderit!

Regjia, do të thotë Sekretaria le t'i regjistrojë emrat, kjo ishte lista e AKR-së.

Në radhë është shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk prezanton listë sot dhe e mbështet propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, siç jemi marrë vesh më herët me shefat e tjerë të grupeve parlamentare. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Nexhat Daci.

(Ndërrhyrje)

Mirë, fjalën e ka kërkuar në emër të LDD-së, kryetari i Partisë, deputeti Nexhat Daci.

NEXHAT DACI: Me kartelë, përmirësoje për procesverbal, Kryetar!

KRYETARI: Mirë. Fol Lulëzim! Lulëzimi ka folur me kartelë të Nexhat Dacit. Urdhëro, Lulëzim!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë propozon listën e kandidatëve për gjyqtarë për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe kandidatë e propozuar nga Grupi Parlamentar i LDD-së, janë:

1. Enver Hasani,
2. Halit Muharremi,
3. Iliriana Islami dhe
4. Gjyljeta Mushkolaj

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Do të thotë, kemi tri lista deri më tani. Radha është e Grupit Parlamentar “7+”. Deputetja Myfera Shinik e ka fjalën!

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim sayan Bakan!

Başkan, başbakan, bakanlar,

Türkiye Cumhuriyeti büyükelçisi ve değerli misafirlerimiz, hepinizi saygıyla selamlıyorum.

7+ Parlamentar Grubu olarak, Hükümet koalisyonunun teklif etmiş olduğu listeyi destekleyerek, aynı zamanda Türk adayımız olan Altay Suroy’un da desteklemesini talep ediyoruz. Teşekkür ederim

KRYETARI: Do të thotë mbështetet lista dhe propozohet kandidati i Grupit Parlamentar “7+”. Ju faleminderit!

Tani është radha e Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Bojan Stojanović e ka fjalën!

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovane kolege poslanici,

Uvaženi premijeru,

Poštovanje Vladinom kabinetu,

Parlamentarna grupa „7+“, takodje ima svog kandidata za sudiju Ustavnog suda, to je prof. dr Ivan Čukalović i molimo vas da ga podržite. Naravno, od predloženih lista, mi ćemo podržati predlog mog kolege, gospodina Ram Buje i naravno predlog kolegenice iz Parlamentarne grupe „7+“. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar “Zajedno”. Sllavisha Petroviq e ka fjalën!

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Mi ćemo glasati za ovaj predlog. Nismo srećni zbog toga što ćemo glasati, ali da ne bi ispali da mi blokiramo izbor članova sudija Vrhovnog suda, pošto je to dosta vrlo bitna institucija i za Srpsku zajednicu, ali opet naglašavam nit smo srećni, niti smo zadovoljni za ovaj predlog, ali ćemo glasati za usaglašene predloge.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Para se të kalojmë në votimin e listës së propozuar, bazuar në dispozitën kushtetuese, kërkoj...

(Reagime në sallë)

...Jo, kërkoj deklarinimin e deputetëve që i mbajnë vendet e rezervuara të komunitetit serb dhe të komunitetit joserb lidhur me dy kandidatët që vijnë nga këto komunitete. Ju e dëgjuat propozimin edhe të komuniteti serb dhe të komuniteteve të tjera të organizuar në Grupin “7+”, do të thotë kemi dy propozime.

(Ndërhyrje nga salla)

Parlament është ky, jemi marrë vesh. Folën shefat e grupeve parlamentare. Kemi filluar me procedim.

... Si e ka emrin ai? Ivan!

... Ju njoftoj se në votimin e parë shkojnë komunitetet pakicë. Prezent janë 20 deputetë, pra nga 24, janë 20 sish.

(Ndërhyrje)

Kemi hyrë në procedurë tash, ju lutem! Votojnë komunitetet pakicë. Lus komunitetet pakicë të votojnë. Votojnë propozimin e Ivan Çukanoviqit. Po, vetëm komuniteti pakicë herën e parë. Lus deputetët e komunitetit pakicë dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

(Ndërhyrje)

Faleminderit! Një kandidat nuk ka kartelë, voton me dorë. Kemi 22 prezent dhe 22 votojnë ” për”. Faleminderit!

Radha është për propozimin e Grupit Parlamentar “7+”. Lus regjinë dhe deputetët e komunitetit pakicë që të përgatiten për votim për propozimin e Grupit Parlamentar” 7+” për kandidatin Altaj Suroi.

Lus regjinë, le të përgatitet për votim. Votojmë tash.

Nga 22, 14 janë “për” me kartelë. Pa kartelë janë 3 veta. Do të thotë 17 “për”, 5 “kundër”, 2 kandidatët kanë marrë votat e komuniteteve pakicë dhe shkojnë në votimin e përbashkët të të gjithë deputetëve.

Pra, lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash për dy kandidatët që u votuan nga komuniteti pakicë.

Kush është pa kartelë? Pa kartelë 6 janë “për”.

Kundër, pa kartelë a ka? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Pra, 71 janë “për”, 3 “kundër” dhe 5 abstenime, që do të thotë Kuvendi zgjodhi 2 anëtarët e Gjykatës Kushtetuese nga komunitetet pakicë. Ju faleminderit!

Vazhdojmë procedurën. Kemi 3 lista. Kemi listën e koalicionit të mbështetur edhe nga AAK-ja, të propozuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja.

A ka nevojë t’i lexoj emrat e kandidatëve? Do të thotë, lista e dytë është lista e AKR-së dhe e treta lista e LDD-së. Sipas renditjes, listat votohen.

Në fillim votojmë listën e propozuar nga koalicioni, të mbështetur nga AAK-ja.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Kush është “për”, pa kartela?

72 + 4, 76 janë “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime.

Sipas listës janë 76, që në fakt janë 2/3 dhe mund të kalojmë në listat e tjera, por s’ka nevojë.

Pra, konstatoj se me 76 vota “për”, 6 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi zgjodhi katër kandidatët e propozuar nga koalicioni për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Pra, ju uroj juve dhe të gjithë qytetarëve zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Prandaj, Kuvendi zgjodhi, nga komuniteti shumicë:

Enver Hasanin,
Gjyljeta Mushkolajn,
Iliriana Islamin dhe
Kadri Kryeziun.

Urime atyre dhe juve!

Pas miratimit nga Kuvendi, lista e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dekretim dhe për dhënien e betimit para Presidentit.

Me kaq, mbyllim seancën. Mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve